



**Numri:** KSC-CC-PR-2017-03

**Vendosi:** **Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese**  
Gjykatëse An Pauër-Ford, kryetare  
Gjykatës Roland Dekers  
Gjykatës Antonio Balsamo

**Administratore:** Fidelma Donlon

**Data:** 28 qershor 2017

**Gjuha origjinale:** Anglishte

**Titulli:** **Referimi i Rregullave të Rishikuara të Rregullores së  
Procedurës dhe të Provave sipas nenit 19(5) të Ligjit**

**PUBLIK**

---

**AKTVENDIM**

**mbi Referimin e Rregullave të Rishikuara të Rregullores së Procedurës dhe të Provave miratuar nga Plenarja më 29 maj 2017, Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese sipas nenit 19(5) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar**

---

## Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese

me përbërjen:

An Pauër-Ford, kryetare  
Roland Dekers, gjykatës  
Antonio Balsamo, gjykatës

pas kuvendimeve të zhvilluara privatisht më 8, 9, 23 dhe 24 qershor 2017, shqipton Aktvendimin e mëposhtëm.

### PJESA I - HYRJJE

#### Historia procedurale

1. Më 17 mars 2017, gjykatësit e Dhomave të Specializuara të mbledhur në seancë plenare ('Plenarja'), në përputhje me nenin 19(1) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ('Ligji'), miratuan Rregulloren e Procedurës dhe të Provave ('Rregullorja'). Gjykatësit kushtetues nuk morën pjesë në miratimin e Rregullores.
2. Më 27 mars 2017, në përputhje me nenin 19(5) të Ligjit, Kryetarja e Dhomave të Specializuara ia referoi Rregulloren Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese ('Gjykata'), për shqyrtimin e përputhshmërisë së saj me Kapitullin II, përfshirë nenin 55, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës ('Kushtetuta').<sup>1</sup>
3. Në Aktvendimin e datës 26 prill 2017,<sup>2</sup> Gjykata konstatoi se rregulla 19(3), rregulla 31, rregulla 32, rregulla 33, rregulla 35(1)(b) dhe (c), rregulla 35(3), rregulla 36(1) dhe (2), rregulla 38(1) dhe (5), rregulla 54(4), dhe rregulla 158(2) e Rregullores ishin në mospërputhje me Kapitullin II të Kushtetutës, dhe për rregullën 134(3) nuk mund të deklaronte se ishte në përputhje me Kapitullin II të Kushtetutës. Gjykata konstatoi se dispozitat e tjera të Rregullores nuk ishin në mospërputhje me Kapitullin II të Kushtetutës.

---

<sup>1</sup> KSC-CC-PR-2017-01, F00001, Referimi i Rregullores së Procedurës dhe të Provave sipas nenit 19(5) të Ligjit, Referimi i Rregullores së Procedurës dhe të Provave, Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese, 27 mars 2017.

<sup>2</sup> KSC-CC-PR-2017-01, F00004, Aktvendim mbi Referimin e Rregullores së Procedurës dhe të Provave miratuar nga Plenarja më 17 mars 2017, Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese sipas nenit 19(5) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, 26 prill 2017 ('Aktvendim i datës 26 prill 2017').

## Referimi

4. Më 29 maj 2017, Plenarja miratoi rregullat e rishikuara të Rregullores së Procedurës dhe të Provave ('Rregullat e Rishikuara'). Gjykatësit kushtetues nuk morën pjesë në miratimin e tyre.
5. Më 31 maj 2017, në përputhje me nenin 19(5) të Ligjit, Rregullat e Rishikuara iu referuan Gjykatës, ('Referimi').<sup>3</sup> Më të njëjtën ditë, Kryetarja e Dhomave të Specializuara caktoi panelin me përbërjen si më lart, në përputhje me nenin 33(3) të Ligjit.

## Pranueshmëria

6. Për të gjykuar në lidhje me Referimin, Gjykata duhet të shqyrtojë nëse janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në Ligj.
7. Fillimisht, Gjykata duhet të shqyrtojë nëse Referimi është bërë nga një person i autorizuar dhe më pas, nëse Gjykata ka kompetencë për shqyrtimin e Rregullave të Rishikuara.
8. Gjykata kujton se, bazuar në nenin 19 të Ligjit, Rregullorja e Procedurës dhe e Provave për kryerjen e procedurave para Dhomave të Specializuara miratohet nga Plenarja e cila ndërmerr veprim në lidhje me cilëndo dispozitë që kjo Gjykatë e shpall mospërputhëse me Kapitullin II të Kushtetutës.
9. Pas shqyrtimit të Rregullores prej Gjykatës, Rregullorja iu kthye Plenares e cila rishikoi dispozitat përkatëse. Më pas, Rregullat e Rishikuara iu referuan kësaj Gjykate për shqyrtim.
10. Rregullat e Rishikuara kanë të bëjnë me kryerjen e procedurave gjyqësore para Dhomave të Specializuara. Rrjedhimisht, ato janë pjesë e juridiksionit lëndor dhe punës së Dhomave të Specializuara dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar.
11. Sipas nenit 49(1) të Ligjit, Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese është autoriteti më i lartë për interpretimin e Kushtetutës në lidhje me çështje që kanë të bëjnë me juridiksionin lëndor dhe punën e Dhomave të Specializuara dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar.
12. Duke qenë se Rregullat e Rishikuara iu referuan kësaj Gjykate pas miratimit të tyre nga Plenarja dhe duke marrë parasysh se Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese si autoriteti më i lartë për interpretimin e Kushtetutës ka kompetencë për shqyrtimin e Rregullave të Rishikuara të miratuara në

---

<sup>3</sup> KSC-CC-PR-2017-03, F00001, Referimi i Rregullave të Rishikuara të Rregullores së Procedurës dhe të Provave sipas nenit 19(5) të Ligjit, Referim i Rregullave të Rishikuara të Rregullores së Procedurës dhe të Provave, Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese, 31 maj 2017.

përputhje me Ligjin, Gjykata e deklaroi të pranueshëm Referimin e datës 31 maj 2017.

### Vërejtje hyrëse

13. Juridiksioni i Gjykatës në lidhje me këtë Referim kufizohet në shqyrtimin e Rregullave të Rishikuara. Gjykata ka për detyrë të përcaktojë nëse Rregullat e Rishikuara, në formën që janë miratuar, janë në përputhje me Kapitullin II, përfshirë nenin 55, të Kushtetutës.
14. Gjykata thekson se, në disa raste, e vetmja mënyrë për të përcaktuar pa mëdyshje nëse një dispozitë e Rregullores është në përputhje me Kushtetutën, do të ishte shqyrtimi i mënyrës së zbatimit të një dispozite konkrete në rrethana konkrete.
15. Në këtë kontekst, Gjykata kujton se për shqyrtimin e Rregullores, Gjykata mbështetet në faktin se gjatë interpretimit dhe zbatimit të Rregullores, do të mbahen parasysh neni 3(2)(a) dhe (e), dhe neni 19(2) i Ligjit. Këto dispozita kërkojnë që Dhomat e Specializuara të gjykojnë dhe funksionojnë në përputhje me Kushtetutën dhe me të drejtën ndërkombëtare për të drejtat e njeriut e cila përcakton standardet në lidhje me procedimet penale, ku përfshihen edhe standardet sipas Konventës Evropiane për Të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore ('Konventa') dhe Konventës Ndërkombëtare për Të Drejtat Civile dhe Politike.

### Vërejtje të përgjithshme

16. Përpara se të kalojë tek konstatimet e veta mbi dispozitat përkatëse të Rregullave të Rishikuara, Gjykata paraqet vërejtjet e përgjithshme si më poshtë.

#### *Kompetencat e Prokurorit të Specializuar*

17. Neni 35 i Ligjit i ngarkon Prokurorit të Specializuar përgjegjësinë për hetimin dhe ndjekjen penale të personave përgjegjës për veprat penale brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara. Ky nen gjithashtu parashtrohet se Prokurori i Specializuar dhe prokurorët e tjerë në Zyrën e Prokurorit të Specializuar kanë jo vetëm përgjegjësinë por edhe *kompetencën* për të kryer funksionet e Zyrës së Prokurorit të Specializuar.
18. Gjykata pajtohet se në përmbushjen e përgjegjësisë për hetimin dhe ndjekjen penale të veprave penale brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara, Prokurori i Specializuar domosdoshmërisht duhet të ketë njëfarë lirie dhe të drejtë gjykimi të brendaqenësishme pa të cilat nuk mund të përmbushet mandati i Zyrës së Prokurorit të Specializuar për realizimin e drejtësisë. Natyrisht, Prokurori i Specializuar është i autorizuar të ndërmarrë një sërë

masash hetimore që në vetvete nuk kërkojnë autorizim gjyqësor paraprak. Në disa raste mund të jenë të nevojshme garanci mbrojtëse më pak të rrepta se kontrolli gjyqësor, si për shembull prania e mbrojtësit gjatë marrjes në pyetje të një të akuzuari. Gjithsesi, faktori kryesor është lloji i masës përkatëse. Sidoqoftë, në parim, sa më e lartë shkalla e ndërhyrjes në të drejtat e njeriut, aq më të rrepta duhet të jenë garancitë mbrojtëse.

19. Gjatë shqyrtimit të Rregullave të Rishikuara, Gjykata vëren se në përgjigje të Aktvendimit të Gjykatës të datës 26 prill 2017, Plenarja ka ndryshuar një numër rregullash në një mënyrë të tillë që kufizon, në disa raste në masë mjaft të konsiderueshme, kompetencat e Prokurorit të Specializuar në lidhje me hetimin e veprave penale. Për shembull, Plenarja ka zvogëluar në masë të qenësishme kategoritë e personave në lidhje me të cilët mund të urdhërohen masa hetimore të posaçme, ose prej të cilëve mund të merren materiale të caktuara si prova.
20. Gjykata e vlerëson të nevojshme të theksojë se Aktvendimi i datës 26 prill 2017 nuk kishte synim të kufizonte në terma të përgjithshme kapacitetin hetimor të Prokurorit të Specializuar. Një gjë e tillë do të rrezikonte të pengonte Prokurorin e Specializuar në ushtrimin e kompetencave të ligjshme dhe detyrimeve ligjore të tij. Faktikisht, Aktvendimi i lartpërmendur kishte synim të garantonte se në rastet kur ushtrimi i kompetencave hetimore të prokurorit cenon të drejtat dhe liritë themelore të njeriut të garantuara me Kushtetutë, është e detyrueshme që ky ushtrim kompetencash t'u nënshtrohet garancive mbrojtëse të duhura, dhe aty ku është e domosdoshme, mbikëqyrjes dhe kontrollit gjyqësor. Në këtë mënyrë arrihet drejtpeshimi i duhur midis interesave konkurrencte publike dhe private.

*Marrëdhëniet konfidenciale dhe masat hetimore*

21. Në Aktvendimin e vet të datës 26 prill 2017, Gjykata vuri re mungesën e dispozitave konkrete për përgjimin e komunikimeve midis një të dyshuari dhe mbrojtësit të vet.<sup>4</sup> Me anë të këtij konstatimi, Gjykata theksoi rëndësinë e parimit të përgjithshëm të privilegjit profesional juridik. Ky privilegj mbron komunikimet midis një këshilltari juridik profesional dhe klientit të tij nga zbulimi i tyre pa lejen e klientit. Privilegji i akorduar klientit synon të garantojë disponueshmërinë e sistemit të drejtësisë për individët.<sup>5</sup>
22. Gjykata vëren se me miratimin e rregullës 31(3), për arsye të kuptueshme Plenarja ka përfshirë një ndalim thuajse të përgjithshëm ndaj zbatimit të

<sup>4</sup> Aktvendim i datës 26 prill 2017, para. 71.

<sup>5</sup> *Krahaso*, për shembull, *Campbell v. the United Kingdom*, 25 mars 1992, Seria A nr. 233, para. 46; *Michaud v. France*, nr. 12323/11, GJEDNJ 2012, para. 117-118. Të gjitha referimet në këtë Aktvendim janë në lidhje me jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut ('GJEDNJ').

masave hetimore në lidhje me informacionin e siguruar në kontekstin e marrëdhënies avokat-klient. Gjykata gjithashtu vëren me një farë rezerve, se Plenarja e ka zgjeruar këtë ndalim nëpërmjet përfshirjes së të gjitha marrëdhënies 'profesionale' ose marrëdhënies të tjera 'konfidenciale', siç përcaktohet në rregullën 111.<sup>6</sup> Për shembull, kjo zbatohet si në lidhje me marrëdhënien mjek-pacient, po ashtu edhe marrëdhënien këshillëdhënës-klient.

23. Gjykata është e ndërgjegjshme për përgjegjësinë e madhe ngarkuar Prokurorit të Specializuar për hetimin e veprave penale brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara, si edhe për rëndësinë e garantimit të mospengimit të Zyrës së Prokurorit të Specializuar në kryerjen e funksioneve të veta. Moslejimi i mundësisë për të kërkuar zbatimin e masave hetimore në lidhje me një spektër të gjerë marrëdhënies konfidenciale, të ndryshme prej marrëdhënies avokat-klient, mund të kufizojë në mënyrë të palejueshme Prokurorin e Specializuar në kryerjen e funksioneve të veta të parapara me Ligj. Komunikimet në kontekst të marrëdhënies avokat-klient janë gjithmonë të privileguara dhe si të tilla në parim nuk duhet të jenë objekt përgjimesh të fshehta. Megjithatë, ndonëse gëzon mbrojtje në një shkallë të lartë në varësi të tërësisë së rrethanave të një rasti konkret, informacioni i siguruar në kontekstin e marrëdhënies të tjera profesionale ose konfidenciale, mund të jetë me rëndësi të konsiderueshme në hetimin e veprave të rënda penale.
24. Gjykata është e mendimit se në parim i takon një gjykate të pavarur që të vlerësojë, në bazë të rrethanave të rastit dhe duke mbajtur parasysh domosdoshmërinë dhe proporcionalitetin e çdo ndërhyrjeje të tillë, nëse do të zbatohen masa hetimore në lidhje me marrëdhënie që janë 'profesionale' apo 'konfidenciale' (përveç marrëdhënies avokat-klient). Një gjykatë e pavarur është ajo që vlerëson nëse do t'i jepet përparësi interesit privat ndaj atij publik në respektimin e konfidencialitetit të një marrëdhënieje të caktuar në hetimin dhe ndjekjen penale të veprave të rënda penale, me kusht që të ekzistojnë garancitë e duhura mbrojtëse.
25. Është me rëndësi të theksohet sërish se synimi i Aktvendimit të mëparshëm të Gjykatës nuk ishte të vendoseshin kufizime të përgjithshme mbi kompetencat e Prokurorit të Specializuar, por të garantohej se në rastet kur ushtrimi i kompetencave të tilla cenon të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, është e detyrueshme që ky ushtrim kompetencash t'u nënshtrohet garancive mbrojtëse të duhura, duke përfshirë aty ku është e domosdoshme, mbikëqyrjen dhe kontrollin gjyqësor.

---

<sup>6</sup> Rregulla 111 përcakton marrëdhëniet profesionale dhe marrëdhëniet e tjera të natyrës konfidenciale në lidhje me të cilat ekziston dispozitë për mosnxjerrjen e komunikimeve dhe informacionit.

26. Në vijim, Gjykata do të paraqesë vlerësimet e veta mbi Rregullat e Rishikuara, në renditjen që janë parashtruar në Referim.

## PJESA II – RREGULLAT E RISHIKUARA

### KAPITULLI 2

#### ORGANIZIMI DHE ADMINISTRIMI I DHOMAVE TË SPECIALIZUARA

27. **Pjesa II: Dhomat**

**Nënpjesa 2: Gjykatësit**

**Rregulla 19 Mungesa e një gjykatësi**

Gjykata vëren se rregulla 19 është ndryshuar për të përjashtuar mundësinë e kryerjes së një gjykimi para dy gjykatësish të një paneli. Tani është e qartë se çfarëdo gjykimi para një trupi gjykues të Dhomave të Specializuara të Kosovës, do të jetë gjykim para një gjykate të themeluar me ligj, siç kërkon neni 31.2 i Kushtetutës.

28. Gjykata konstaton se rregulla 19 nuk është në mospërputhje me Kapitullin II të Kushtetutës.

### KAPITULLI 3

#### HETIMET

29. **Pjesa I: Masat hetimore**

**Nënpjesa 1: Të përgjithshme**

Gjykata kujton konstatimin e vet në Aktvendimin e datës 26 prill 2017, se disa rregulla në lidhje me masat hetimore ishin në mospërputhje me Kapitullin II të Kushtetutës, duke qenë se nuk i përmbushnin kriteret e ‘cilësisë së ligjit’ dhe ‘domosdoshmërisë’ sipas nenit 36 dhe nenit 55 të Kushtetutës.<sup>7</sup> Në përgjigje të Aktvendimit të Gjykatës të datës 26 prill 2017, përveç rishikimit të dispozitave ekzistuese të Kapitullit 3, Plenarja ka përfshirë edhe disa rregulla të reja.

30. **Rregulla 30 dhe rregulla 31**

Plenarja ka rishikuar rregullën 30 mbi ‘dispozitat e përgjithshme’ dhe ka miratuar një rregull të re – rregullën 31 – e cila parashtron ‘garanci minimale të përgjithshme’ të zbatueshme në lidhje me të gjitha masat hetimore që mund të cenojnë të drejtat themelore të njeriut. Në këto dispozita lexohet si vijon:

*Rregulla 30 Dispozita të përgjithshme*

(1) *Gjatë hetimit të një veprë penale brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara, Prokurori i Specializuar mund:*

<sup>7</sup> Shih Aktvendim i datës 26 prill 2017, para. 75, 88, 95, 106-107.



- (a) *të marrë në pyetje viktimë, dëshmitarë dhe të dyshuar dhe të regjistrujë deklaratat e tyre;*
  - (b) *të kryejë hetime në vendngjarje, të mbledhë prova, të kryejë ekspertimin e provave të mbledhura, dhe sipas nevojës, të kryejë veprimtari të tjera hetimore;*
  - (c) *të kërkojë ndihmën e shteteve të treta dhe të organizatave ndërkombëtare, apo subjekteve të tjera;*
  - (d) *të marrë masa hetimore të përcaktuara në rregullën 34 deri në rregullën 41.*
- (2) *Gjatë hetimit, Prokurori i Specializuar vepron çdo herë në përputhje me të drejtat themelore të njeriut, të parapara në Kapitullin II të Kushtetutës dhe garanton:*
- (a) *sigurinë dhe mbrojtjen e viktimave, dëshmitarëve dhe personave të tjerë të rrezikuar për shkak të dhënies së informacionit Zyrës së Prokurorit të Specializuar apo bashkëpunimit me Zyrën e Prokurorit të Specializuar; dhe*
  - (b) *mbrojtjen e privatësisë së cilitdo personi.*

### **Rregulla 31      Garanci minimale të përgjithshme**

- (1) *Një panel autorizon ose, kur është e zbatueshme, Prokurori i Specializuar ndërmer masa hetimore të cilat mund të cenojnë të drejtat themelore të njeriut të parapara në Kapitullin II të Kushtetutës. Masa të tilla mund të autorizohen ose ndërmerren, sipas rastit, në qoftë se duke mbajtur parasysh të gjitha rrethanat përkatëse, përmbushen garancitë minimale të mëposhtme:*
- (a) *plotësohen kushtet përkatëse, të përcaktuara në rregullën 34 deri në rregullën 41;*
  - (b) *masat hetimore janë të domosdoshme për hetimin; dhe*
  - (c) *ndërhyrja e shkaktuar në të drejtën e cilitdo personi për integritet personal, privatësi apo pronë, është proporcionale me qëllimin legjitim të hetimit dhe nuk mohon thelbin e të drejtës së garantuar.*
- (2) *Në rast se autorizon masa hetimore sipas paragrafit (1), paneli mund të urdhërojë Prokurorin e Specializuar që të dorëzojë informacion në lidhje me zbatimin e këtyre masave, si edhe në lidhje me materialin e mbledhur në bazë të rregullës 34 deri në rregullën 41, në mënyrën dhe brenda afatit që përcakton paneli.*
- (3) *Informacioni i siguruar në kontekstin e marrëdhënieve profesionale apo marrëdhënieve të tjera konfidenciale përcaktuar në rregullën 111, konsiderohet i privilegjuar dhe nuk u nënshtrohet masave hetimore, përveç nëse statusi i privilegjuar keqpërdoret për të kryer një veprë penale brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara dhe provat që kërkohen, kanë*



*kontribuuar në kryerjen e asaj vepre penale. 2Në një rast të tillë, rregulla 33(1)(a)(ii) zbatohet mutatis mutandis.*

(4) *Sipas nevojës, paneli mund të përcaktojë edhe garanci të tjera mbrojtëse.*

31. Gjykata vëren se në rregullën 30, Plenarja ka përfshirë një kriter ‘ombrellë’ që përmban një numër ‘dispozitash të përgjithshme’ të zbatueshme në lidhje me të gjitha hetimet dhe të cilat, ndër të tjera, i ngarkojnë Prokurorit të Specializuar detyrimin për të vepruar çdo herë në një mënyrë që është në përputhje me të drejtat themelore të njeriut.
32. Gjykata gjithashtu vëren se në rregullën 31, Plenarja ka përfshirë disa ‘garanci minimale të përgjithshme’ të zbatueshme në lidhje me të gjitha masat hetimore që mund të cenojnë të drejtat themelore të njeriut, përfshirë masat hetimore të posaçme, kontrollimet dhe sekuestrimet, zhvarrosjet dhe ekzaminimet *post-mortem*, dhe mbledhjen e materialeve trupore—masa të cilat që të gjitha përbëjnë ndërhyrje të qartë në të drejtat themelore të njeriut.
33. Gjykata mirëpret dispozitat plotësuese të përfshira në Rregulloren të cilat janë formuluar për të siguruar mbrojtje më të madhe të të drejtave themelore të njeriut.
34. Gjykata kujton se të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë, mund të kufizohen vetëm ‘me ligj’. Kjo nënkupton, ndër të tjera, se ligji duhet të jetë i parashikueshëm për sa i përket efektit të vet, që do të thotë se duhet të jetë i formuluar me saktësi të mjaftueshme për t’i mundësuar individit—sipas nevojës me anë të këshillave të duhura – që të rregullojë sjelljen e vet. Në lidhje me këtë, Gjykata thekson se në rregullën 31(1), kufiri midis masave që ‘autorizon një panel’ nga njëra anë, dhe masave të cilat mund ‘të ndërmerren Prokurori i Specializuar, kur është e zbatueshme’ nga ana tjetër, nuk është menjëherë i dallueshëm, por bëhet i qartë kur lexohet bashkërisht me rregullat e tjera të Kapitullit 3.
35. Rrjedhimisht, rregulla 31(1) është e zbatueshme në lidhje me të gjitha masat hetimore që kryen Prokurori i Specializuar të cilat mund të cenojnë të drejtat themelore të njeriut, pavarësisht nëse: (i) kërkojnë autorizim gjyqësor paraprak; (ii) mund të ndërmerren pa autorizim gjyqësor paraprak, por kërkojnë miratim gjyqësor *ex post facto*; ose (iii) mund të ndërmerren pa autorizim gjyqësor paraprak dhe pa miratim gjyqësor *ex post facto*. Kjo qasje përputhet me nenin 55 të Kushtetutës.
36. Rregulla 31(2) autorizon një panel që të urdhërojë Prokurorin e Specializuar për t’i raportuar në lidhje me zbatimin e masave të autorizuara, në mënyrën dhe brenda ‘afatit që përcakton paneli’. Për të shmangur paqartësitë, Gjykata konsideron se ‘afatet’ e përmendura në këtë dispozitë janë vetëm afatet që i caktohen Prokurorit të Specializuar për dorëzimin e informacionit në lidhje

me zbatimin e masave hetimore dhe materialin e mbledhur, jo afatet për zbatimin e masave hetimore, ose mbajtjen e materialit të mbledhur.

37. Rregulla 31(3) parashtron se informacioni i siguruar në kontekstin e 'marrëdhënieve profesionale apo *marrëdhënieve të tjera konfidenciale*' (përcaktuar në rregullën 111) konsiderohet i privilegjuar dhe '*nuk u nënshtrohet masave hetimore*' përveçse në një rast të vetëm, përkatësisht kur statusi i privilegjuar keqpërdoret për të kryer një vepër penale. Gjykata kujton vërejtjet e paraqitura më lart në lidhje me faktin që Plenarja u ka dhënë status të privilegjuar (dhe rrjedhimisht i ka përjashtuar prej masave hetimore) të gjitha 'marrëdhënieve profesionale, apo marrëdhënieve të tjera konfidenciale', përcaktuar në rregullën 111.<sup>8</sup> Megjithëse Rregullorja mund të përmbajë standarde jashtëzakonisht të larta për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, zbatimi i tyre në praktikë nuk duhet të ndalojë ose pengojë Prokurorin e Specializuar në kryerjen e detyrave të ligjshme të tij.
38. Së fundi, Gjykata vlerëson se fraza '*përveç nëse ... provat që kërkohen kanë kontribuar në kryerjen e asaj vepre penale*' në rregullën 31(3) kërkon një koment të shkurtër. Pjesa e parë e fjalisë në thelb parashtron se informacioni i siguruar në kontekstin e marrëdhënieve konfidenciale nuk u nënshtrohet masave hetimore. Kjo vlen vetëm, '*përveç nëse*' statusi i privilegjuar 'keqpërdoret' për të kryer një vepër penale, ku me sa duke në këtë rast informacioni i siguruar në kontekstin e një marrëdhënieje konfidenciale nuk ka status të privilegjuar dhe *mund* t'u nënshtrohet masave hetimore. Megjithatë, është e vështirë të kuptohet se si 'provat që kërkohen' mund të 'kontribuojnë në kryerjen e asaj vepre penale'. Me sa duket, në një situatë të tillë 'provat që kërkohen', kërkohen nga Prokurori i Specializuar të cilat në një situatë tjetër do të ishin informacioni i 'privilegjuar', i siguruar në kontekstin e marrëdhënies konfidenciale. Është e vështirë të përfytyrohet se si informacioni që kërkohet prej Prokurorit të Specializuar mund të '*kontribuojë*' në kryerjen e veprës penale që është duke u hetuar. Prokurori i Specializuar nuk kërkon prova që *kontribuojnë në kryerjen e një vepre penale*. Prokurori i Specializuar kërkon prova që shërbejnë si tregues të një vepre penale. Gjykata mendon se fraza 'provat që kërkohen' u referohet provave konfirmuese ose të tërthorta të kryerjes së një vepre penale. Për sa i përket fjalisë së fundit të rregullës 31(3), sipas interpretimit të Gjykatës kjo fjali i referohet pjesës së parë të fjalisë paraprake, konkretisht provat e siguruara nëpërmjet shkeljes së një privilegji që duhej të ishte respektuar.
39. Duke mbajtur parasysh vërejtjet e Gjykatës, Plenarja mund të vendosë të shqyrtojë dispozitat e rregullës 31, në një datë të mëvonshme. Gjithsesi, Gjykata konstaton se, duket se rregulla 30 dhe rregulla 31 nuk përmbajnë asgjë që në vetvete është në mospërputhje me Kapitullin II të Kushtetutës.

---

<sup>8</sup> Shih më lart, para. 21-26.

#### 40. Rregulla 32 dhe rregulla 33

Rregulla 32 dhe rregulla 33 përcaktojnë mbajtjen, ruajtjen, mbrojtjen, kthimin dhe asgjësimin e materialit të mbledhur apo të sekuestruar nga Prokurori i Specializuar sipas rregullës 34 deri në rregullën 41. Në Aktvendimin e vet të datës 26 prill 2017, Gjykata formuloi konstatime mbi mungesën e garancive mbrojtëse të mjaftueshme në lidhje me këto aspekte, veçanërisht në lidhje me të dhëna të siguruar mbi bazën e përgjimit të fshehtë dhe materialet trupore të mbledhura gjatë hetimeve.<sup>9</sup> Garanci të tilla janë të domosdoshme bazuar në nenin 36.4 të Kushtetutës, sipas të cilit çdo person gëzon 'të drejtën e mbrojtjes së të dhënave personale' dhe 'mbledhja, ruajtja, qasja, korrigjimi dhe shfrytëzimi i të dhënave personale rregullohet me ligj'.

41. Konstatimeve të Gjykatës në lidhje me pamjaftueshmërinë e garancive mbrojtëse në aspekte të ndryshme të identifikuara në Aktvendim, Plenarja u është përgjigjur duke miratuar dispozita që mund të përshkruhen si 'gjithëpërfshirëse' apo të gjithmbarshme. Rregulla 32 dhe rregulla 33 që rregullojnë mbajtjen, ruajtjen, mbrojtjen, kthimin dhe asgjësimin e materialit, tani janë të zbatueshme në lidhje me të gjitha materialet e siguruar nëpërmjet masave hetimore të posaçme, kontrollimit dhe sekuestrimit, zhvarrosjeve dhe ekzaminimeve *post mortem*, si edhe mbledhjes së materialeve trupore.

42. Rregulla 32 dhe rregulla 33 parashtrojnë si në vijim:

***Rregulla 32      Mbajtja, ruajtja dhe mbrojtja e materialit të mbledhur  
 apo të sekuestruar sipas rregullës 34 deri në rregullën 41***

- (1) *Materiali i mbledhur apo i sekuestruar si rezultat i zbatimit të një mase të paraparë në rregullën 34 deri në rregullën 41, mbahet, ruhet dhe mbrohet në mënyrën e duhur. Çdo vendim i një paneli për autorizimin e një mase të tillë përmban:*
- (a) *procedurën dhe masat paraprake për ruajtjen, mbrojtjen, dhe kur është e zbatueshme transferimin e materialit të mbledhur apo të sekuestruar;*
  - (b) *kohëzgjatjen e mbajtjes së materialit të mbledhur apo të sekuestruar, dhe kur është e zbatueshme procedurën për ruajtjen e tij sipas rregullës 71; dhe*
  - (c) *udhëzime dhe afate për kthimin ose, kur është e zbatueshme, asgjësimin e materialit të mbledhur apo të sekuestruar.*
- (2) *Rregulla 206 zbatohet mutatis mutandis. Kërkesat e autoriteteve të Kosovës mund të miratohen në varësi të masave mbrojtëse, nëse është e nevojshme.*

---

<sup>9</sup> Aktvendim i datës 26 prill 2017, para. 66, 73-75, 105-106, i referohet *S. and Marper v. the United Kingdom* [GC], nr. 30562/04 dhe nr. 30566/04, GJEDNJ 2008, para. 120, 122.

**Rregulla 33** *Kthimi ose asgjësimi i materialit të mbledhur apo të sekuestruar sipas rregullës 34 deri në rregullën 41*

(1) *Materiali i mbledhur apo i sekuestruar sipas rregullës 34 deri në rregullën 41, kthehet ose asgjësohet:*

(a) *menjëherë,*

(i) *në qoftë se një material i tillë nuk lidhet me qëllimin e hetimit për të cilin është mbledhur, veçse kur është i rëndësishëm për hetimin e një veprë penale tjetër brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara; ose*

(ii) *në qoftë se një material i tillë është mbledhur në mënyrë të paligjshme, veçanërisht nëse paneli nuk miraton, ose nuk nxjerr vendim në lidhje me një urdhër të Prokurorit të Specializuar sipas rregullës 36 ose rregullës 38;*

(b) *kur një material i tillë pushon së qeni i rëndësishëm në lidhje me qëllimin për të cilin është mbledhur, duke mbajtur parasysh:*

(i) *llojin dhe peshën e veprës penale;*

(ii) *nevojat e hetimeve në kryerje e sipër; dhe*

(iii) *nëse personi përkatës është një i dyshuar, i shpallur fajtor, i shpallur i pafajshëm ose një person i tretë; ose*

(c) *nëse kanë kaluar afatet e parashkrimit të ndjekjes penale të përcaktuara në nenin 106 të Kodit Penal të Kosovës.*

(2) *Në varësi të paragrafit (1), materiali i mbledhur apo i sekuestruar sipas rregullës 34 deri në rregullën 41:*

(a) *kthehet prej Prokurorit të Specializuar proprio motu, ose me vendim të panelit; ose*

(b) *asgjësohet prej Prokurorit të Specializuar vetëm me vendim të panelit.*

*Evidentimi i çdo kthimi ose asgjësim të tillë të materialit është i detyrueshëm.*

(3) *Personi përkatës njoftohet për çdo vendim për kthimin, ose asgjësimin e materialit, të paktën nëntëdhjetë (90) ditë përpara zbatimit të një vendimi të tillë, ose në përputhje me një vendim tjetër. Personi në fjalë mund të kërkojë rishikimin e një vendimi të tillë.*

43. Gjkata kujton se në Aktvendimin e vet të mëparshëm, ajo theksoi se për shkak të shkallës së lartë të ndërhyrjes në të drejtën e privatësisë, çdo ligj lidhur me masat e përgjimit dhe vëzhgimit të fshehtë, duhet të përmbajë, ndër të tjera:

- procedurën që duhet të ndiqet gjatë analizimit, përdorimit dhe ruajtjes së të dhënave të mbledhura;

- masat që duhen marrë gjatë komunikimit të këtyre të dhënave palëve të tjera; dhe
- saktësimin e rrethanave në të cilat regjistrimet mund ose duhet të fshihen apo asgjësohen.<sup>10</sup>

Gjykata gjithashtu theksoi nevojën që Rregullorja të përmbajë garancitë e duhura mbrojtëse në lidhje me mbajtjen e materialeve trupore të mbledhura nga Prokurori i Specializuar.<sup>11</sup>

44. Gjykata vëren se në rregullën 32(1), Plenarja parashtron se materiali i mbledhur apo i sekuestruar si rezultat i zbatimit të një mase të paraparë në rregullën 34 deri në rregullën 41, mbahet, ruhet dhe mbrohet ‘në mënyrën e duhur’, por nuk përcakton procedurën që mundëson mbajtjen, ruajtjen dhe mbrojtjen e materialit ‘në mënyrën e duhur’. Plenarja ka zgjedhur që këto kompetenca t’ia delegojë një paneli. Është detyrë e panelit që në urdhrin e vet për autorizimin e masave përkatëse të përfshijë udhëzime në lidhje me ‘procedurën dhe masat paraprake për ruajtjen, mbrojtjen dhe transferimin’ e materialit në fjalë. Paneli është autoriteti që duhet të përcaktojë afatet në lidhje me mbajtjen dhe ruajtjen e të dhënave. Paneli ka për detyrë që të nxjerrë udhëzime në lidhje me kthimin ose asgjësimin e materialeve.
45. Gjykata pranon se nevojitet kohë dhe ekspertizë e konsiderueshme për zhvillimin e procedurave të hollësishme në lidhje me, për shembull, si duhet të ‘mbahen në mënyrën e duhur’ të dhënat celulare, regjistrimet e bisedave private apo materiale të tjera të ndjeshme. Ka shumë të ngjarë që një panel mund të kërkojë udhëzime të ekspertëve në lidhje me procedurat e ruajtjes dhe mbrojtjes së një materiali të tillë, në qoftë se duhet të saktësojë procedura të tilla në urdhrin e vet. Gjithsesi, në praktikë nuk do të mjaftojë vetëm që një paneli t’i delegohet detyra e përcaktimit të procedurës për shembull, në lidhje me mbajtjen e indeve trupore.
46. Gjykata nuk mund të anashkalojë faktin që kriteri i parashikueshmërisë së ligjit mund të vihet në rrezik në qoftë se çdo panel ka lirinë që të përcaktojë procedurat e veta në lidhje me këto aspekte.<sup>12</sup> Për të përmbushur kriterin e lartpërmendur, ligji duhet të shprehë me qartësi të mjaftueshme shkallën e lirisë së gjykimit që i jepet autoritetit kompetent dhe mënyrën e zbatimit të kësaj kompetence.<sup>13</sup> Standardi që duhet përmbushur është gjithnjë e më i lartë, duke qenë se rregulla 32 dhe rregulla 33 mbulojnë të gjitha llojet e të dhënave të siguruar dhe materialeve të mbledhura, apo të sekuestruara në bazë të

<sup>10</sup> Aktvendim i datës 26 prill 2017, para. 66, i referohet *Roman Zakharov v. Russia* [GC], nr. 47143/06, GJEDNJ 2015, para. 231.

<sup>11</sup> *Shih* Aktvendim i datës 26 prill 2017, para. 105-106.

<sup>12</sup> *Shih* Aktvendim i datës 26 prill 2017, para. 62-63, 90.

<sup>13</sup> *Shih S. and Marper v. the United Kingdom*, cituar më lart, para. 95.

rregullës 34 deri në rregullën 41, përfshirë të dhëna personale tejet të ndjeshme, si për shembull mostrat e ADN-së.

47. Gjykata vlerëson se qasja e miratuar mund të shkaktojë një përshtypje pasaktësie në kontekstin e 'cilësisë së ligjit' dhe për Dhomat e Specializuara të hapur rrezikun e vendosjes së standardeve mospërputhëse, në varësi të procedurave të urdhëruara prej cilitdo paneli. Për këtë arsye, është e qartë se do të nevojiten udhëzime rregulluese konkrete (në formën e direktivave, udhëzuesve apo rregulloreve në të ardhmen), në mënyrë që të plotësohen dispozitat ekzistuese të rregullës 32, veçanërisht në lidhje me aspektet teknike, si për shembull mbajtja dhe ruajtja e llojeve të caktuara të të dhënave.
48. Gjithsesi, Gjykata mirëpret faktin që rregulla 32 dhe rregulla 33 përmbajnë dispozita konkrete për rrethanat në të cilat materialet e mbledhura apo të sekuestruara mund, ose duhet të asgjësohen. Duke iu përmbajtur parimeve thelbësore të identifikuar në Aktvendimin e 26 prillit 2017, rregulla 32 dhe rregulla 33 kërkojnë që mbajtja e materialeve të cilat përmbajnë të dhëna personale duhet të jetë (i) e rëndësishme për hetimin; (ii) proporcionale me qëllimin e mbledhjes së materialit; dhe (iii) me afat të kufizuar
49. Së fundi, duke qenë se një vendim për kthimin ose asgjësimin e materialeve sipas rregullës 33(3) mund të lidhet me të drejtat kushtetuese, Gjykata e vlerëson të rëndësishme të theksojë se përveç të drejtës për 'rishikimin' e një vendimi të tillë, Ligji dhe Rregullorja parashikojnë edhe mjete të tjera ligjore, duke përfshirë, kur është e zbatueshme, të drejtën për të apeluar vendimin para Gjykatës së Apelit, ose të drejtën për t'iu drejtuar kësaj Gjykate.
50. Me gjithë konstatimin e Gjykatës se në praktikë do të nevojiten procedura shitesë për të plotësuar dispozitat e rregullës 32, Gjykata konstaton se, duket se rregulla 32 dhe rregulla 33 nuk janë në mospërputhje me Kapitullin II të Kushtetutës.

## 51. Nën pjesa 2: Masa hetimore të posaçme

Në Aktvendimin e vet të datës 26 prill 2017, Gjykata gjykoi se në lidhje me masat hetimore të posaçme është e domosdoshme të ekzistojnë garanci minimale thelbësore. Gjykata mbështeti mendimin e GJEDNJ-së se jo vetëm që duhet të ekzistojnë garanci mbrojtëse, por ato duhet gjithashtu të saktësohen qartë në ligj, në mënyrë që të parandalohet mundësia e keqpërdorimit të pushtetit.<sup>14</sup> Krahas dispozitave të përgjithshme të lartpërmendura, në përgjigje të Aktvendimit të Gjykatës Plenarja ka miratuar edhe rregullën 34, rregullën 35 dhe rregullën 36.

## 52. Rregulla 34 Kushtet për marrjen e masave hetimore të posaçme

---

<sup>14</sup> Shih Aktvendim i datës 26 prill 2017, para. 62-64.



Rregulla 34 parashtron si më poshtë:

- (1) *Në varësi të rregullës 31(1), masa hetimore të posaçme mund të ndërmerren vetëm nëse ekziston dyshim i bazuar se është kryer, është duke u kryer apo do të kryhet një vepër penale përcaktuar në nenin 13 ose 14 të Ligjit, ose vepër penale përcaktuar në nenet 388(2) dhe (3), 393, 394(1), (4) dhe (5), 395, 396, 397(1), 400(2) deri në (4), 409, 410, 423 ose 424, të Kodit Penal të Kosovës, siç përmendet në nenin 15(2) të Ligjit.*
  - (2) *Masa hetimore të posaçme mund të ndërmerren kur provat nuk mund të sigurohen me anë të ndonjë mase tjetër më pak ndërhyrëse por po aq të efektshme, dhe merren në lidhje me një person ose vend konkret, kur ekziston dyshim i bazuar se:*
    - (a) *personi në fjalë ka kryer, është duke kryer, ose do të kryejë cilëndo vepër penale nga paragrafi (1), brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara;*
    - (b) *personi në fjalë merr ose përcjell komunikim për të dyshuarin apo të akuzuarin, ose prej të dyshuarit apo të akuzuarit, ose mjete i tij i komunikimit përdoret prej të dyshuarit ose të akuzuarit;*
    - (c) *një vend konkret përdoret apo do të përdoret për kryerjen e një vepre penale nga paragrafi (1), brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara; ose*
    - (d) *provat në lidhje me një vepër penale nga paragrafi (1) mund të zbulohen në një vend konkret dhe provat e kërkuara janë të domosdoshme për hetimin.*
  - (3) *Personi i përmendur në paragrafin (2) njoftohet nga Prokurori i Specializuar për cilëndo masë të ndërmarrë në lidhje me të në bazë të rregullës 34 deri në rregullën 36, me kusht që kjo të mos rrezikojë qëllimin e masës së ndërmarrë ose kryerjen e procedurave.*
53. Në përputhje me çka kërkohet nga parimet e shqiptuara në Aktvendimin e 26 prillit 2017,<sup>15</sup> rregulla 34 përcakton llojin e veprave penale që mund të përliqjin urdhërimin ose zbatimin e masave hetimore të posaçme, përfshirë edhe urdhrat për përgjim. Në nënparagrafin(2), kjo rregull përcakton gjithashtu kategoritë e personave në lidhje me të cilët mund të jepet urdhër për masa hetimore të posaçme.
54. Ndonëse në Aktvendimin e vet të datës 26 prill 2017 Gjykata vuri në dukje mungesën e kategorive të personave që mund të jenë objekt i masave hetimore të posaçme, ajo vëren se Rregullat e Rishikuara identifikojnë kategori shumë të kufizuara në lidhje me të cilat mund të merren masa të tilla. Këto janë (i) të dyshuarit; (ii) ata që marrin ose përcjellin komunikime për të dyshuarin ose të akuzuarin, ose prej të dyshuarit ose të akuzuarit; dhe (iii) ata, mjete i

<sup>15</sup> Shih Aktvendim i datës 26 prill 2017, para. 66, 69-71.



komunikimit i të cilëve përdoret prej të dyshuarit ose të akuzuarit. Megjithatë, ndoshta shumë informacion mund të sigurohej nga përgjimi i fshehtë i sjelljes ose komunikimeve të të tjerëve (përfshirë edhe shkelës të tjerë të ligjit) që mund të kenë informacione me rëndësi. Mirëpo, këta mund të jenë të përjashtuar nga kategoritë e tanishme. Si rrjedhojë, mund të ngrihet pyetja nëse kjo listë e ngushtë rrezikon të bëhet pengesë për Prokurorin e Specializuar në përmbushjen e përgjegjësisive të veta sipas Ligjit. Gjykata kujton detyrimin e fortë procedural që ka Prokurori i Specializuar për të kryer hetim të efektshëm dhe rrënjësor të pretendimeve për vdekje të dhunshme, keqtrajtim, ose zhdukje në rrethana kërcënuese për jetën.

55. Ndonëse sipas Gjykatës, kategoritë e ngushta të personave që mund t'u nënshtrohen masave hetimore të posaçme janë kufizuese dhe mund të jetë e nevojshme që Plenarja t'i rishikojë për të mundësuar hetime rrënjësore, detyra e kësaj Gjykate është vetëm që të garantojë se Rregullat e Rishikuara përputhen me Kapitullin II të Kushtetutës. Gjykata mund të nxjerrë përfundimin se, duket se rregulla 34 nuk është në mospërputhje me Kapitullin II të Kushtetutës.

**56. Rregulla 35 dhe rregulla 36**

Rregullat 35 dhe 36 përcaktojnë si më poshtë:

***Rregulla 35 Masa hetimore të posaçme të autorizuar prej një paneli***

- (1) *Për marrjen e masave hetimore të posaçme, Prokurori i Specializuar kërkon autorizimin e një paneli.*
- (2) *Kur është bindur se janë plotësuar kushtet e rregullës 31(1) dhe rregullës 34, paneli mund të nxjerrë një vendim për autorizimin e masave hetimore të posaçme të kërkuara, në të cilin përmenden:*
  - (a) *periudha kohore për të cilën jepet autorizimi, në varësi të rrethanave përkatëse të hetimit, e cila nuk mund të zgjasë më shumë se gjashtëdhjetë (60) ditë;*
  - (b) *procedura e raportimit në lidhje me zbatimin e masave të autorizuar dhe materialin e mbledhur, qoftë brenda afateve të rregullta, ose me përfundimin e masave, varësisht nga vendimi i panelit, në përputhje me rregullën 31(2);*
  - (c) *autorizimi për hyrje në një vend konkret, në rast se është e nevojshme për zbatimin, vijimin, ose përfundimin e masës hetimore përkatëse. Për një autorizim të tillë nuk është i detyrueshëm njoftimi i të dyshuarit apo të akuzuarit, përveç nëse në rrethanat përkatëse të çështjes, paneli gjykon se njoftimi i të dyshuarit apo të akuzuarit nuk rrezikon efektshmërinë e masës së kërkuar.*
- (3) *Periudha kohore përcaktuar në paragrafin (2)(a) mund të zgjatet më së shumti deri 12 muaj në qoftë se me gjithë zellin e duhur të Prokurorit të*

*Specializuar, qëllimi i hetimit nuk është realizuar dhe ende përmbushen kushtet e parapara në rregullën 31(1) dhe rregullën 34.*

- (4) *Në rrethana të jashtëzakonshme, të përcaktuara nga faktorë si pesha e veprës penale, kompleksiteti i hetimit ose konstatimi se me gjithë zellin e duhur Prokurori i Specializuar ka zbuluar rrethana të reja pak përpara përfundimit të masës përkatëse, periudha e përcaktuar në paragrafin (3) mund të zgjatet edhe më tej. Paneli rishikon rregullisht masat e miratuara të paktën çdo gjashtëdhjetë (60) ditë dhe mund t'i përfundojë ato në çdo kohë, në qoftë se kushtet përkatëse nuk përmbushen më dhe në qoftë se kjo diktohet nga detyrimi i respektimit të të drejtave të njeriut.*

**Rregulla 36 Masa hetimore të posaçme të urdhëruara prej Prokurorit të Specializuar**

- (1) *Prokurori i Specializuar mund të urdhërojë masa hetimore të posaçme pa autorizimin e një paneli në qoftë se janë përmbushur kushtet e përcaktuara në rregullën 31(1) dhe rregullën 34, dhe:*
- (a) *zbatimi i menjëhershëm i masave të tilla është i domosdoshëm për mundësimin e mbledhjes së provave të cilat nuk mund të sigurohen në një mënyrë tjetër; dhe*
- (b) *çdo vonesë si rezultat i kërkimit të autorizimit prej panelit do të rrezikonte hetimin apo sigurinë e një dëshmitari, viktime, ose personi tjetër të rrezikuar.*
- (2) *Prokurori i Specializuar i paraqet panelit kërkesë për miratimin e masave të tilla menjëherë dhe jo më vonë se njëzet e katër (24) orë pas fillimit të zbatimit të tyre.*
- (3) *Paneli që shqyrton kërkesën miraton masa hetimore të posaçme brenda tri (3) ditësh nga paraqitja e kërkesës, vetëm nëse bindet se janë përmbushur kushtet e paragrafit (1). Rregulla 35 zbatohet mutatis mutandis.*
- (4) *Në qoftë se një kërkesë e tillë nuk është paraqitur, nuk është miratuar, ose paneli nuk ka nxjerrë vendim në lidhje me të, urdhri i Prokurorit të Specializuar për masa hetimore të posaçme pushon së qeni në fuqi dhe Prokurori i Specializuar ndërpret menjëherë masat përkatëse. Materiali i mbledhur, në qoftë se ka, nuk mund të përdoret për hetim apo ndjekje penale.*

57. Rregulla 35 dhe rregulla 36 përcaktojnë garanci të rëndësishme që mungonin në versionin fillestar të rregullave lidhur me masat hetimore të posaçme.<sup>16</sup> Konkretisht, duke iu referuar shprehimisht kërkesave të rregullës 31(1) dhe rregullës 34, dispozitat e rishikuara për masat hetimore të posaçme sigurojnë që, në përputhje me nenin 55 të Kushtetutës, masa të tilla autorizohen dhe zbatohen vetëm nëse: (i) janë të nevojshme për hetimin; (ii) ndërhyrja që

<sup>16</sup> Shih Aktvendim i datës 26 prill 2017, në veçanti para. 64-69, 72, 75.

rezulton është proporcionale me qëllimin legjitim të hetimit; dhe (iii) ndërhyrja që rezulton nuk mohon thelbin e së drejtës së garantuar.

58. Rregulla 35 parashtron masat hetimore të posaçme të autorizuar prej një paneli. Ajo përcakton kufij të qartë për kohëzgjatjen e masave të tilla, ndër të cilat mund të përfshihen vëzhgimi dhe përgjimin i fshehtë i komunikimeve, dhe i ngarkon panelit detyrimin për të përcaktuar periudhën kohore për të cilën të jepet autorizimi. Ndonëse e lë kohëzgjatjen e përgjithshme të çfarëdo mase hetimore të posaçme në gjykimin e panelit, rregulla 35 përcakton garanci mbrojtëse të efektshme, si për shembull, kufizim të qartë të periudhës fillestare për të cilën mund të autorizohet një masë hetimore e posaçme (gjashtëdhjetë ditë), kushtet në të cilat mund të zgjatet periudha fillestare e miratuar, rrethanat në të cilat duhet të përfundojnë masat e autorizuar,<sup>17</sup> dhe kontrolli dhe mbikëqyrja gjyqësore e domosdoshme në zbatimin e masës.<sup>18</sup>
59. Rregulla 36 parashtron masat hetimore të posaçme që mund të urdhërohen ose ndërmerren prej Prokurorit të Specializuar në rrethana të përcaktuara dhe që i nënshtrohen kontrollit gjyqësor *ex post facto* përmes kërkesës për shqyrtim dhe miratim gjyqësor. Në rastet kur ndiqet një proces i tillë, dispozitat e rregullës 35 zbatohen *mutatis mutandis*.
60. Gjykata është bindur se, duket se rregulla 35 dhe rregulla 36 nuk janë në mospërputhje me Kapitullin II të Kushtetutës.

### 61. Nënpjesa 3: Kontrollimi dhe sekuestrimi

#### **Rregulla 37 Kontrollimi dhe sekuestrimi i autorizuar prej një paneli**

Në Aktvendimin e 26 prillit 2017, Gjykata vërejti se versioni i mëparshëm i kësaj dispozite (më parë rregulla 34) ishte hartuar në terma të përgjithshme dhe se nuk përcaktonte detyrimin e panelit për të shqyrtuar 'domosdoshmërinë' e një operacioni kontrollimi dhe sekuestrimi.<sup>19</sup> Plenarja ka miratuar rregullën 37 në të cilën parashtrohet si më poshtë:

- (1) *Prokurori i Specializuar i kërkon një paneli autorizim për kontrollim dhe sekuestrim në qoftë se në rrethanat konkrete provat nuk mund të sigurohen në një mënyrë tjetër dhe kontrollimi dhe sekuestrimi i kërkuar duket se është e vetmja masë e efektshme për nevojat e hetimit.*
- (2) *Paneli mund të autorizojë kontrollimin e pronës së një personi ose të vendeve, ambienteve, ose objekteve të tjera në lidhje me të cilat personi në fjalë ka*

<sup>17</sup> Shih *Roman Zakharov v. Russia*, cituar më lart, para. 250; *Kennedy v. the United Kingdom*, nr. 26839/05, 18 May 2010, para. 161.

<sup>18</sup> Shih *Roman Zakharov v. Russia*, cituar më lart, para. 233; *Greuter v. the Netherlands* (dec.), nr. 4004590, 19 mars 2002; *Klass and Others v. Germany*, 6 shtator 1978, Series A nr. 28, para. 55.

<sup>19</sup> Aktvendim i datës 26 prill 2017, para. 81-82.

*prishmëri të arsyeshme për respektimin e privatësisë, si dhe të autorizojë sekuestrimin e sendeve të gjetura gjatë kontrollimit, në qoftë se:*

- (a) *ekziston dyshim i bazuar se personi në fjalë ka kryer, është duke kryer, ose do të kryejë një vepër penale brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara dhe kontrollimi do të rezultojë në arrestimin e atij personi, ose në zbulimin dhe sekuestrimin e provave të domosdoshme për hetimin;*
  - (b) *ekziston dyshim i bazuar se kontrollimi do të rezultojë në arrestimin e një të dyshuari; ose*
  - (c) *kontrollimi është i domosdoshëm për mbledhjen dhe ruajtjen e provave për një vepër penale brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara dhe ekziston dyshim i bazuar se prova të tilla gjenden në pronën, vendin, ose objektin që do të kontrollohet.*
- (3) *Paneli mund të autorizojë kontrollimin e një personi në qoftë se ekziston dyshim i bazuar se kontrollimi do të rezultojë në zbulimin e provave për një vepër penale brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara dhe rrjedhimisht në sekuestrimin e provave të tilla.*
- (4) *Në rast se bindet se kushtet e përcaktuara në paragrafët (1) deri në (3), në varësi të rrethanave, si dhe kushtet e parapara në rregullën 31(1), paneli mund të marrë vendim për autorizimin e kontrollimit dhe sekuestrimit i cili përmban:*
- (a) *kohën, kohëzgjatjen dhe shkallën e kontrollimit dhe sekuestrimit, duke përfshirë të dhëna për personin ose pronën, vendin, ambientin ose objektin në lidhje me të cilat autorizohet masa përkatëse; dhe*
  - (b) *procedurën e raportimit në lidhje me zbatimin e masës së autorizuar dhe materialin e sekuestruar, në përputhje me rregullën 31(2).*
- (5) *Paneli mund të përcaktojë edhe kushte të tjera që i gjykon të nevojshme.*

#### *Kriteri i domosdoshmërisë*

62. Fillimisht, Gjykata vëren se rregulla 37(1) parashtrojnë një kriter shumë të rreptë të domosdoshmërisë në lidhje me kushtet sipas të cilave Prokurori i Specializuar kërkon autorizim prej një paneli për kontrollim dhe sekuestrim. Konkretisht, Prokurori i Specializuar mund ta bëjë këtë kur provat e kërkuara (i) *'nuk mund të sigurohen në ndonjë mënyrë tjetër'* dhe (ii) kur masa hetimore *'duket se është e vetmja masë e efektshme për nevojat e hetimit'* (theksimi i shtuar). Gjykata vë në dukje pragun e lartë që duhet të arrijë Prokurori i Specializuar. Madje në shënimin shpjegues për këtë dispozitë, Plenarja ka konfirmuar se kjo rregull *'është ndryshuar duke përfshirë një kriter më të rreptë në lidhje me domosdoshmërinë e kontrollimit dhe sekuestrimit (e vetmja masë e efektshme ...).'*<sup>20</sup>

<sup>20</sup> Referimi, Shtojca I, f. 11 (theksimi i shtuar).

63. Gjykata kujton se në Aktvendimin e vet të mëparshëm nuk konstatoi se nevojitej një “kriter më i rreptë” i domosdoshmërisë. Gjykata theksoi se “sipas neneve 36.2 dhe 55.2 të Kushtetutës dhe në bazë të nenit 8(2) të Konventës, çdo ndërhyrje në të drejtat dhe liritë themelore që është pasojë e kontrollimeve dhe sekuestimeve, duhet të përmbushë kushtin e ‘domosdoshmërisë’.<sup>21</sup> Gjykata gjithashtu vërejti se kushti i domosdoshmërisë ‘përfshin detyrimin për të analizuar, *nëse ka lidhje*, nëse provat e synuara mund të merren në mënyra të tjera më pak ndërhyrëse, por po aq efektive...’.<sup>22</sup> Rrjedhimisht, jo në çdo rast kërkohet të analizohet nëse ka mënyra të tjera të marrjes së provave. Kjo kërkohet vetëm në rastet kur kjo çështje ka lidhje, duke marrë parasysh të gjitha rrethanat mbizotëruese.<sup>23</sup> Domosdoshmëria nënkupton gjithashtu se ndërhyrja ose kufizimi konkret në të drejtat në fjalë duhet të përkojë me një nevojë të ngutshme shoqërore dhe të jetë proporcionale me synimin legjitim që kërkohet të arrihet.<sup>24</sup>
64. Gjatë analizimit të proporcionalitetit të një ndërhyrjeje në çfarëdo rasti konkret janë disa elemente që mund të kenë rëndësi. Ndër to përfshihen: pesha e veprës penale në lidhje me të cilën kryhen kontrollimi dhe sekuestrimi; mënyra dhe rrethanat në të cilat jepet urdhri, veçanërisht nëse ka prova të mëtjeshme ekzistuese në atë kohë; përmbajtja dhe fushëveprimi i urdhrit— duke mbajtur parasysh në veçanti llojin e mjediseve të kontrolluara — dhe masat mbrojtëse të zbatuara për ta mbajtur ndikimin e masës brenda kufijve të arsyeshëm. Së fundi, mund të ketë rëndësi edhe shkalla e pasojave të mundshme mbi reputacionin e personit, të shkaktuara nga kontrollimi.<sup>25</sup>
65. Gjykata vëren se disa prej Rregullave të Rishikuar tashmë përmbajnë dispozita që kanë për qëllim të garantojnë zbatimin e kushtit të domosdoshmërisë dhe proporcionalitetit në rrethanat e cilitdo rasti konkret. Përveç garancive mbrojtëse që përmban rregulla 37(2), (3), (4) dhe (5), në paragrafin (1)(c) të rregullës ‘ombrellë’ 31 e zbatueshme për të gjitha masat hetimore, kërkohet që paneli të analizojë nëse ndërhyrja që rezulton është proporcionale me synimin

<sup>21</sup> Aktvendim i datës 26 prill 2017, para. 78.

<sup>22</sup> Aktvendim i datës 26 prill 2017, para. 82 (theksimi i shtuar).

<sup>23</sup> Në çështjen e *Buck v. Germany*, GJEDNJ-ja konsideroi të rëndësishëm faktin që kontrollimi dhe sekuestrimi i kryer në atë rast nuk kishte qenë e vetmja mënyrë për të përcaktuar se kush ishte përgjegjës për veprën penale në fjalë. Duke konstatuar se ndërhyrja nuk kishte qenë proporcionale, GJEDNJ-ja vuri në dukje ‘rrethanat e veçanta të çështjes...’ ku ‘kontrollimi dhe sekuestrimi në fjalë ishin urdhëruar në lidhje me një shkelje të vogël të një rregulle që pretendohet se ishte kryer nga një person i tretë dhe që përfshinte mjediset e banimit privat të aplikuesit ...’. Shih *Buck v. Germany*, nr. 41604/98, ECHR 2005-IV, para. 52.

<sup>24</sup> Aktvendim i datës 26 prill 2017, para. 79.

<sup>25</sup> *Buck v. Germany*, cituar më lart, para. 45. Shih edhe *Cacuci and S.C. Virra & Cont Pad S.R.L. v. Romania*, cituar më lart, para. 91; *Camenzind v. Switzerland*, 16 dhjetor 1997, Raporte Aktgjykimesh dhe Vendimesh 1997-VIII, para. 46.



legjitim të hetimit, dhe në paragrafin (4) panelit i lejohet të përcaktojë garanci të tjera mbrojtëse 'sipas nevojës'.

66. Duke mbajtur parasysh sa më lart, Gjykata rithekson se standardet më të larta të së drejtës ndërkombëtare të të drejtave të njeriut nuk diktojnë një 'kriter më të rreptë' të domosdoshmërisë në kontekstin e kërimit të autorizimit gjyqësor për operacione kontrollimi dhe sekuestrimi. Në Rregullore janë disa dispozita synimi i të cilave është të garantojnë që paneli të vlerësojë si domosdoshmërinë, po ashtu edhe proporcionalitetin e një operacioni kontrollimi dhe sekuestrimi dhe këto janë të mjaftueshme për të përmbushur standardet e kërkuara.
67. Gjykata është e mendimit se është e rëndësishme të theksohet që gjatë interpretimit dhe zbatimit të rregullës 37, në praktikë, ndërkohë që garanton që çdo ndërhyrje të jetë në përputhje me ligjin, paneli gjithashtu duhet të ketë parasysh drejtpeshimin e duhur që duhet mbajtur midis ushtrimit nga një person i të drejtave kushtetuese për integritet dhe privatësi nga njëra anë dhe nga ana tjetër, domosdoshmërisë që Prokurori i Specializuar të marrë masa të efektshme për hetimin e veprave penale të rënda brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara.<sup>26</sup>

*'Pritshmëria e arsyeshme për privatësi'*

68. Gjykata vëren se rregulla 37(2) parashtron se paneli mund të autorizojë kontrollimin e pronës dhe objekteve 'në lidhje me të cilat personi në fjalë ka pritshmëri të arsyeshme për respektimin e privatësisë'. Duke pasur parasysh kompetencën e Prokurorit të Specializuar sipas Ligjit, Gjykata konsideron se Prokurorit të Specializuar mund t'i duhet të bëjë kontrollime dhe sekuestrime edhe të pronave dhe objekteve të tjera, përveç atyre në lidhje me të cilat personat e identifikuar në paragrafët (2)(a) dhe (b) kanë pritshmëri të arsyeshme për privatësi.
69. Në lidhje me kriterin e 'pritshmërisë së arsyeshme për privatësi' sipas rregullës 37(2), Gjykata vëren se koncepti i 'jetës private' sipas nenit 36 të Kushtetutës, i interpretuar në përputhje me jurisprudencën e GJEDNJ-së, është një term i gjerë që nuk ka një përkufizim shterues. Ekziston një zonë në ndërveprimet e një personi me të tjerët, edhe në kontekstin publik, e cila mund të përfshihet brenda fushës së 'jetës private'. Ka një numër elementesh me rëndësi për shqyrtimin nëse masat e ndërmarra jashtë banesës apo mjediseve private të një personi, ndikojnë në jetën private të atij personi. Në këtë drejtim, pritshmëria e arsyeshme e personit për sa i përket privatësisë mund të jetë një

---

<sup>26</sup> Shih, *mutatis mutandis*, *Murray v. The United Kingdom*, 28 tetor 1994, Series A nr. 300-A, para. 91; *Klass and others v. Germany*, cituar më lart, Series A nr. 28, para. 59.

faktor i rëndësishëm, ndonëse jo domosdoshmërisht vendimtar.<sup>27</sup> Në qasjen mbi 'pritshmërinë e arsyeshme për privatësi' në rregullën 37(2), paneli duhet të mbështetet në nocionin e 'jetës private' sipas Kushtetutës, interpretuar në përputhje me jurisprudencën e GJEDNJ-së.

70. Duke marrë parasysh detyrimin e Dhomave të Specializuara për të gjykuar dhe funksionuar në përputhje me Kushtetutën dhe të drejtën ndërkombëtare të të drejtave të njeriut sipas nenit 3(2) të Ligjit, Gjykata konstaton se, duket se rregulla 37 nuk është në mospërputhje me Kapitullin II të Kushtetutës.

**71. Rregulla 38 Kontrollimi dhe sekuestrimi i urdhëruar prej Prokurorit të Specializuar**

Gjykata vëren se rregulla 38 (më parë rregulla 35) mbulon operacionet e kontrollimit dhe sekuestrimit të kryera pa autorizim gjyqësor paraprak. Në Aktvendimin e vet të 26 prill 2017, Gjykata konstatoi se rregulla 35(1)(b),(c) dhe (3) nuk ishte në përputhje me nenet 36.2, 55.2 dhe 55.4 të Kushtetutës, sepse i mungonin garancitë mbrojtëse që disa kompetenca të gjera të ushtruara nga Prokurori i Specializuar të kufizoheshin në çka ishte 'e domosdoshme' për qëllimin legjitim të synuar dhe se operacione të tilla nuk drejtpeshoheshin prej një shqyrtimi gjyqësor të përshtatshëm *ex post facto*.<sup>28</sup> Rregulla 38 i ka materializuar konstatimet e Gjykatës në këtë drejtim. Në të lexohet si vijon:

- (1) Bazuar në nenin 35 dhe nenin 39 të Ligjit dhe në përputhje me kushtet e përcaktuara në rregullën 37 (1-3), Prokurori i Specializuar, pa autorizimin e një paneli, mund të kryejë kontrollimin e një personi ose prone, vendi, ambienteve apo objekti, dhe të sekuestrojë përkohësisht çfarëdo sendi të gjetur gjatë kontrollimit, në qoftë se:
  - (a) personi në fjalë me vetëdije dhe vullnetarisht pajtohet me kryerjen e kontrollimit dhe sekuestrimin;
  - (b) personi në fjalë është kapur duke kryer një veprë penale brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara dhe pas ndjekjes nga afër do të arrestohet; ose
  - (c) një veprim i tillë është i domosdoshëm për të parandaluar rrezikun e menjëhershëm të një dëmi të rëndë dhe të pandreqshëm ndaj personave të tjerë ose pronës.
- (2) Kërkesën për miratimin e kontrollimit dhe sekuestrimit, Prokurori i Specializuar ia parqet një paneli menjëherë dhe jo më vonë se njëzet e katër (24) orë pas fillimit të kontrollimit dhe sekuestrimit.

---

<sup>27</sup> *Gillan and Quinton v. the United Kingdom*, cituar më lart, para. 61. Shih edhe *Uzun v. Germany*, cituar më lart, para. 44.

<sup>28</sup> Aktvendim i datës 26 prill 2017, para. 86-88.



- (3) *Paneli që shqyrton kërkesën mund të miratojë kontrollimin dhe sekuestrimin brenda tri (3) ditësh nga paraqitja e kërkesës vetëm nëse bindet se janë plotësuar kushtet e përcaktuara në paragrafin (1).*
- (4) *Në qoftë se një kërkesë e tillë nuk është paraqitur, nuk është miratuar, ose paneli nuk ka nxjerrë vendim në lidhje me të, urdhri i Prokurorit të Specializuar për kontrollim dhe sekuestrim pushon së qeni në fuqi dhe Prokurori i Specializuar ndërpret menjëherë kontrollimin dhe sekuestrimin. Materiali i sekuestruar, në qoftë se ka, nuk mund të përdoret për hetim apo ndjekje penale.*
72. Fillimisht, Gjykata vëren se rregulla 38 përcakton qartë rrethanat dhe kushtet në të cilat Prokurori i Specializuar mund të kryejë kontrollim dhe sekuestrim pa autorizim paraprak nga gjykata. Duke iu referuar rregullës 37(1-3), rregulla 38(1) kërkon që Prokurori i Specializuar të shqyrtojë domosdoshmërinë e operacionit. Gjithashtu, ky detyrim i Prokurorit të Specializuar është përcaktuar në rregullën 31(1)(b). Me rëndësi është fakti se rregulla 31(1)(c) kërkon që Prokurori i Specializuar të shqyrtojë proporcionalitetin e ndërhyrjes që rezulton. Për më tepër, rregulla 38(3) parashikon një shqyrtim gjyqësor *ex post facto* që trajton problemet lidhur me ligshmërinë dhe proporcionalitetin e masës, si dhe me mënyrën e zbatimit të masës. Bazuar në sa më sipër, Gjykata është bindur se Plenarja i ka marrë parasysh konstatimet e bëra në Aktvendimin e 26 prillit 2017.
73. Gjykata vëren se rregulla 38(1) parashtron rrethanat në të cilat Prokurori i Specializuar mund të kryejë kontrollim dhe sekuestrim pa autorizim gjyqësor paraprak. Sidoqoftë, kjo dispozitë nuk përcakton shprehimisht rrethanat kur ekziston rreziku i humbjes së provave, në qoftë se nuk kryhet një operacion i menjëhershëm kontrollimi dhe sekuestrimi. Gjykata pranon se mund të jetë e nevojshme që në një situatë të tillë Prokurori i Specializuar të veprojë pa autorizim gjyqësor paraprak, me qëllim që të përmbushë detyrimet e veta ligjore.
74. Baza ligjore e kompetencës së Prokurorit të Specializuar për kryerjen e një operacioni në rrethana të tilla gjendet në nenin 36.2 të Kushtetutës, që në pjesën përkatëse thotë si vijon:
- Kontrollet e cilësdo banese ose cilitdo objekt privat, që mendohet se janë të domosdoshme për hetimin e krimit mund të bëhen ... pas miratimit nga ana e gjykatës .... Shmangia nga kjo rregull lejohet nëse është e domosdoshme ... për mbledhjen e provave që ka rrezik të humbasin ose për mënjanimin e rrezikut të drejtpërdrejtë dhe serioz për njerëzit dhe për pasuri në mënyrën e përcaktuar me ligj ....*
75. Krahas kësaj, Gjykata konsideron me rëndësi faktin që, sipas nenit 110(3) të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK), zyrtarët e autorizuar policorë

mund të fillojnë kontrollim pa një urdhër paraprak me shkrim, por në bazë të lejes gojore nga një gjykatës kompetent kur ekziston 'një rrezik real për vonesë që mund të rezultojë me humbjen e provave ...'. Kjo dispozitë është marrë parasysh sepse neni 162.6 i Kushtetutës parashtron se 'Dhomat e Specializuara mund t'i përcaktojnë Rregullat e veta të Procedurës dhe Provave ... dhe të udhëzuara nga Kodi i Procedurës Penale të Kosovës ...'.

76. Gjykata kujton se Rregullorja duhet interpretuar në atë mënyrë që është në përputhje me Kushtetutën. Në lidhje me sa më lart, Gjykata është e mendimit se përmendja e 'dëmtimit të pakthyeshëm ... të pronës' në rregullën 38(1)(c) duhet interpretuar se përfshin situatat në të cilat ekziston rreziku i humbjes së provave.
77. Duke pasur parasysh detyrimin e Dhomave të Specializuara për të gjykuar dhe funksionuar në përputhje me Kushtetutën dhe të drejtën ndërkombëtare të të drejtave të njeriut në bazë të nenit 3(2) të Ligjit, Gjykata konstaton se rregulla 38 nuk është në mospërputhje me Kapitullin II të Kushtetutës.

**78. Rregulla 39 Kryerja e kontrollimit dhe sekuestrimit**

Gjykata vëren se rregulla 39 (më parë rregulla 36) trajton kryerjen e operacioneve të kontrollimit dhe sekuestrimit. Në Aktvendimin e 26 prillit 2017, Gjykata konstatoi se paragrafi (1) dhe paragrafi (2) të rregullës 36 nuk ishin në përputhje me nenin 55.1 të Kushtetutës, duke qenë se nuk ishin formuluar me shkallën e kërkuar të saktësisë.<sup>29</sup> Për pasqyrimin e këtyre konstatimeve, Plenarja ka miratuar rregullën 39. Kjo dispozitë vijon më poshtë:

- (1) *Në varësi të paragrafit (2), kontrollimi dhe sekuestrimi në bazë të rregullës 37 ose rregullës 38, kryhen prej Prokurorit të Specializuar në prani të personit përkatës dhe para kryerjes së kontrollimit dhe sekuestrimit, Prokurori i Specializuar:*
- (a) *i jep një kopje të legalizuar të vendimit të panelit apo të urdhrimit të Prokurorit të Specializuar personit ndaj të cilit është marrë vendimi ose urdhri përkatës;*
- (b) *informon personin në fjalë për të drejtat e tij sipas rregullës 42 ose rregullës 43, në varësi të rrethanave;*
- (c) *siguron që mbrojtësi i personit të jetë i pranishëm gjatë kontrollimit dhe sekuestrimit, përveç nëse personi heq dorë vullnetarisht nga ushtrimi i kësaj të drejte, apo logjikisht nuk mund të pritë prania e mbrojtësit; dhe*
- (d) *siguron praninë e një vëzhguesi të pavarur i cili shërben si dëshmitar gjatë kryerjes së kontrollimit dhe sekuestrimit.*

<sup>29</sup> Aktvendim i datës 26 prill 2017, para. 90-95.

- (2) *Kontrollimi dhe sekuestrimi mund të kryhen edhe pa praninë e personit përkatës në qoftë se ky person nuk mund të gjendet ose refuzon të jetë i pranishëm gjatë kryerjes së kontrollimit dhe kur çdo vonesë në kryerjen e kontrollimit dhe sekuestrimit do të rrezikonte hetimin apo sigurinë ose pronën e një dëshmitari, viktime apo personi tjetër të rrezikuar. Zbatohen paragrafi (1)(c), nëse është e realizueshme, dhe (d). Personi përkatës informohet për kryerjen e kontrollimit dhe sekuestrimit menjëherë pasi të përcaktohet vendndodhja e tij.*
- (3) *Gjatë kryerjes së kontrollimit dhe sekuestrimit bëhet kujdes që të shmanget çfarëdo dëmtimi i panevojshëm i pronës.*
- (4) *Prokurori i Specializuar dokumenton kohën e kryerjes, kohëzgjatjen, shkallën, dhe të gjitha hollësitë e tjera të kontrollimit dhe sekuestrimit. Në rastet kur paneli ka përcaktuar kushte plotësuese në lidhje me kryerjen e kontrollimit dhe sekuestrimin, dokumentohet edhe zbatimi i kushteve plotësuese. Prokurori i Specializuar përpilon listën e inventarit të sendeve të sekuestruara me përshkrim dhe informacion të hollësishëm në lidhje me secilin send të sekuestruar. Prokurori i Specializuar, vëzhguesi i pavarur, personi përkatës dhe mbrojtësi i tij, në qoftë se është i pranishëm, nënshkruajnë listën e inventarit dhe mund të bëjnë vërejtje me shkrim në lidhje me kryerjen e kontrollimit dhe sekuestrimit. Dokumentohet edhe refuzimi i personit përkatës për të nënshkruar dokumentin, si edhe arsyet e refuzimit.*
- (5) *Prokurori i Specializuar mban dhe ruan sendet e sekuestruara në përputhje me rregullën 32.*
79. Fillimisht, Gjykata vëren se rregulla 39 saktëson qartësisht se kjo rregull trajton operacionet e kontrollimit dhe sekuestrimit të kryera si me autorizim gjyqësor paraprak, po ashtu edhe pa të. Gjithashtu, aty përcaktohen me shkallën e kërkuar të saktësisë, procedurat që duhen zbatuar në kryerjen e operacioneve të kontrollimit dhe sekuestrimit. Rrjedhimisht, Gjykata është bindur se Plenarja i ka marrë parasysh konstatimet e bëra në Aktgjykimin e 26 prillit 2017.
80. Gjithsesi, Gjykata është e mendimit se disa vërejtje në lidhje me rregullën 39 janë me vend. Konkretisht, Gjykata vëren se në rregullën 39(2) përkufizohen rrethanat në të cilat Prokurori i Specializuar mund të anashkalojë disa prej hapave procedurale që është i detyruar të përmbushë gjatë kryerjes së kontrollimit dhe sekuestrimit sipas paragrafit (1). Sipas rregullës 39(1)(a), para kryerjes së operacionit, Prokurori i Specializuar ka detyrim t'i japë personit përkatës një kopje të legalizuar të vendimit të panelit, apo urdhrin të Prokurorit të Specializuar. Gjithsesi, në Rregullore pranohet se një masë e tillë nuk është e mundshme në qoftë se personi në fjalë nuk është i pranishëm dhe në rrethana të tilla zbatohen dispozitat e rregullës 39(2).

81. Në rast të mungesës së personit, në bazë të rregullës 39(2), Prokurori i Specializuar siguron praninë e mbrojtësit, nëse është e realizueshme, dhe të një vëzhguesi të pavarur. Gjykata pajtohet se prania e një vëzhguesi të pavarur shërben si garanci kundër shpërdorimit dhe arbitraritetit, veçanërisht në raste që kanë të bëjnë me kontrollimin e zyrës së një avokati.<sup>30</sup> Gjykata është e mendimit se në rrethana të jashtëzakonshme, Prokurorit të Specializuar mund t'i duhet të fillojë me kontrollimin pavarësisht nga ardhja e vonuar e një vëzhguesi të pavarur. Një faktor i tillë nuk është domosdoshmërisht vendimtar në vlerësimin nëse është shkelur e drejta kushtetuese e privatësisë së një personi. Një vlerësim i tillë bëhet në varësi të rrethanave të një rasti konkret.
82. Duke mbajtur parasysh detyrimin e Dhomave të Specializuara për të gjykuar dhe funksionuar në përputhje me Kushtetutën dhe të drejtën ndërkombëtare për të drejtat e njeriut sipas nenit 3(2) të Ligjit, Gjykata konstaton se rregulla 39 nuk është në mospërputhje me Kapitullin II të Kushtetutës.

*Përgjimet dhe kontrollimet e telekomanduara*

83. Në kontekstin e masave hetimore dhe më konkretisht, të kryerjes së kontrollimeve të pronës së një të dyshuari, Gjykata vëren se Rregullorja nuk përcakton konkretisht kontrollime të telekomanduara të pajisjeve të kompjuterizuara synimi i të cilave është mbledhja e provave përkatëse, ose kopjimi i të dhënave. Autoritetet hetimore i konsiderojnë gjithmonë e më shumë kontrollimet e telekomanduara të pajisjeve të të dyshuarve si një instrument hetimor i rëndësishëm dhe i domosdoshëm në luftën kundër veprave penale të rënda dhe komplekse, duke qenë se kontrollime të tilla u mundësojnë autoriteteve në fjalë të kërkojnë dhe sigurojnë prova që ndryshe nuk do të ishin të disponueshme. Duhet bërë dallim midis kontrollimeve të tilla të telekomanduara dhe kontrollimit më të rëndomtë të diskut të palëvizshëm të një kompjuteri ose të pajisjeve të bartshme pas sekustrimit fizik. Këto kontrolle mund të dallohen edhe nga përgjimi i fshehtë i komunikimeve që kryhen përmes kompjuterit. Për shembull, kontrollimet e telekomanduara me anë të programeve kompjuterike të përshtatshme, mund të përfshijnë shënimin e një fjale kyçe për gjetjen e provave që mund të jenë të rëndësishme për hetimin e një të dyshuari.
84. Në disa raste, nëpërmjet kontrollimeve të telekomanduara autoritetet hetimore mund të kenë qasje në të gjitha të dhënat e ruajtura në pajisjen e një individi, si dhe në informacionin dalës dhe hyrës në atë pajisje. Ky lloj kontrolli hetimor me gjasë u mundëson autoriteteve që të mbledhin një sasi qenësisht më të madhe të dhënash, shumë prej të cilave mund të jenë tejet personale ose të ndjeshme. Ky lloj kontrolli potencialisht është i një shkalle të lartë

---

<sup>30</sup> Shih *Lindstrand Partners Advokatbyrå AB v. Sweden*, nr. 18700/09, 20 dhjetor 2016, para. 95, me referime të mëtejshme.

ndërhyrëse krahasuar me veprimtari të fshehta tradicionale si përgjimi i telefonit. Rrjedhimisht, kontrolli i telekomanduar mund të paraqesë sfida të veçanta kundrejt të drejtës për privatësi.

85. Në rast se Prokurori i Specializuar bën kërkesë për një urdhër për kontrollim të telekomanduar në Internet, Rregullorja përmban një numër dispozitash që i ngarkojnë panelit detyrimin për ruajtjen e drejtpeshimit midis interesave të përfshira. Për shembull, në rregullën 31 panelit i kërkohet të vlerësojë domosdoshmërinë dhe proporcionalitetin e një ndërhyrjeje. Disa rregulla ofrojnë garanci mbrojtëse minimale në aspektin e infiltrimit teknik. Rregulla 34 dhe rregulla 35 në lidhje me masat hetimore të posaçme, saktësojnë llojin e veprave penale në lidhje me të cilat mund të përligjen urdhra të tillë, saktësojnë kategoritë e personave në lidhje me të cilët mund të zbatohen masa të tilla, përcaktojnë afatin e masave të tilla dhe detyrimin për njoftimin e personit që është objekt i këtyre masave.
86. Me gjithë këto garanci ekzistuese, kontrollimi i telekomanduar është një masë e një shkalle të lartë ndërhyrëse në lidhje me të cilin nevojiten kushte më të rrepta për të garantuar që ndërhyrja përkatëse të mbetet brenda kufijve kushtetues të lejueshëm. Ndër këto kushte mund të përfshihen procedura konkrete në lidhje me të dhëna mbi një aspekt themelor të jetës private, zvogëlimi i kategorive të veprave penale në lidhje me të cilat mund të përligjet një urdhër i tillë dhe miratimi i masave me kohëzgjatje më të shkurtër. Ndër garanci të tjera mund të përmenden që çfarëdo ndryshimi në sistemin e teknologjisë informative që kontrollohet, të zhbëhet automatikisht për aq sa është teknikisht e mundshme, që niveli i sigurisë së një aparati të mos ulet dhe që informacioni kyç në lidhje me metodat teknike të regjistrohet dhe evidentohet.
87. Për sa u përket standardeve më të larta të kërkuara në lidhje me infiltrimin teknik, Gjykata vëren se kushti i rreptë i parashtruar në rregullën 37(1) në lidhje me operacionet e kontrollimit dhe sekuestrimit – që kontrollimi mund të kryhet në qoftë se provat ‘nuk mund të sigurohen në një mënyrë tjetër’ dhe ‘duket se është e vetmja masë e efektshme për nevojat e hetimit’ – do të ishte një standard i përshtatshëm për kontrollimet e telekomanduara. Në të njëjtën kohë, për të shmangur bllokimin e vetë qëllimit të një kontrollimi të telekomanduar, lipset të rishikohet detyrimi që i ngarkohet Prokurorit të Specializuar në rregullën 39(1)(a) që para kryerjes së kontrollimit t’i japë personit përkatës një kopje të legalizuar të vendimit.
88. Për sa më lart dhe për t’i mundësuar Prokurorit të Specializuar që gjatë hetimeve të veta të përdorë kontrollimin e telekomanduar, Plenarja mund t’i marrë në shqyrtim sërish masa të tilla, duke garantuar njëkohësisht që çfarëdo ndryshimi i Rregullores të artikulojë drejtpeshimin midis dobive të qenësishme që sigurohen përmes përdorimit të instrumenteve të qasjes së

telekomanduar për efikasitetin hetimor dhe nga ana tjetër, shkallës më të lartë të ndërhyrjes ndaj të drejtës për privatësi.

89. Pavarësisht nga sa më lart, Gjykata konstaton se, duket se rregulla 39 nuk është në mospërputhje me Kapitullin II të Kushtetutës.

90. **Nënpjesa 4: Masa të tjera**

**Rregulla 41 Mbledhja e materialeve trupore për ekspertizë mjekoligjore**

Gjykata vëren se mbledhja e materialeve trupore për ekspertizë mjeko-ligjore trajtohej në rregullën e mëparshme 38(1). Në Aktvendimin e 26 prillit 2017, Gjykata konstatoi se rregulla 38(1) ishte në mospërputhje me nenin 55.2 dhe 55.4 të Kushtetutës, duke qenë se në atë dispozitë mungonin garancitë e mjaftueshme për kryerjen e ekspertizave pa pëlqimin e personit.<sup>31</sup> Për pasqyrimin e këtyre konstatimeve, Plenarja ka miratuar rregullën 41. Kjo dispozitë vijon si më poshtë:

- (1) *Mbledhja e qimeve, pështymës, mostrave të gjakut, indeve trupore ose materialeve të tjera të ngjashme, të cilat nuk mund të merren pa kontakt fizik ose ndërhyrje trupore në trupin e një personi, mund të kryhet me miratim me shkrim dhe të dhënë vullnetarisht të personit përkatës, pasi personi në fjalë të jetë këshilluar me mbrojtësin e vet, ose me vetëdije të ketë hequr dorë nga e drejta për t'u këshilluar me mbrojtësin e vet.*
- (2) *Në mungesë të një miratimi të tillë, një panel mund të autorizojë masat e parapara në paragrafin (1) në lidhje me një person, në qoftë se:*
  - (a) *ekziston dyshim i bazuar se personi në fjalë ka kryer një veprë penale brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara; ose*
  - (b) *zbulimi i të vërtetës kërkon që të përcaktohet nëse në trupin e personit përkatës ka gjurmë apo pasojat e një veprë penale brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara.*
- (3) *Për marrjen e vendimit, dhe sipas nevojës, pasi të ketë dëgjuar personin në fjalë, paneli merr parasysht, ndër të tjera:*
  - (a) *llojin dhe peshën e veprës penale;*
  - (b) *në qoftë se materialet që kërkohen mund të sigurohen me anë të një metode tjetër;*
  - (c) *procedurën përkatëse për kryerjen e ekspertizës mjeko-ligjore; dhe*
  - (d) *pasojat për shëndetin e personit në fjalë.*
- (4) *Mbledhja e mostrave të gjakut, indeve trupore ose materialeve të tjera të ngjashme mund të kryhet vetëm prej një eksperti të kualifikuar mjekësor.*

<sup>31</sup> Aktvendim i datës 26 prill 2017, para. 106.



(5) *Materiali i përmendur në paragrafët (1) dhe (2) nuk përdoret për asnjë qëllim tjetër, përveç se për hetimin dhe ndjekjen e veprave penale brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara.*

91. Paraprakisht, Gjykata vëren se kompetenca e Prokurorit të Specializuar për mbledhjen e materialeve trupore për ekspertizë mjeko-ligjore është kufizuar në masë të konsiderueshme. Konkretisht, në paragrafin (2) përcaktohen vetëm dy kategori personash në lidhje me të cilët paneli mund të autorizojë marrjen e materialeve trupore në rrethana kur personi në fjalë nuk pranon të japë pëlqimin. Në një kategori përfshihen të dyshuarit dhe në tjetrën persona në trupin e të cilëve mund të ketë gjurmë apo pasoja të një veprë penale. Këto kategori janë të ngushta dhe mund të ndikojnë në kryerjen e detyrës prej Prokurorit të Specializuar për përmbushjen e detyrimit për kryerjen e një hetimi të efektshëm. Për shembull, Prokurorit të Specializuar mund t'i duhet të bëjë ekspertizën e materialit trupor të një dëshmitari apo të çfarëdo personi tjetër që ka qenë i pranishëm në vendin e një krimi. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se qëllimi i Aktvendimit të 26 prillit 2017 nuk ishte të kufizohej mundësia e Prokurorit të Specializuar për kryerjen e hetimeve, por të bëhej e qartë se në Rregullore mungonin garanci të mjaftueshme në rastet kur personi në fjalë refuzonte të jepte pëlqimin për marrjen e materialit trupor. Rrjedhimisht, Plenarja mund të marrë në shqyrtim mundësinë e zgjerimit të kategorive të personave të përmendur në paragrafin (2).
92. Për sa i përket mungesës së garancive të mjaftueshme të konstatuara në Aktvendimin e Gjykatës të datës 26 prill 2017, Gjykata vëren se në rast se personi në fjalë refuzon të japë pëlqimin, në rregullën 41(2) kërkohet autorizimi i panelit për marrjen e materialit trupor. Gjithashtu, Gjykata vëren se në rregullën 41(3) kërkohet që paneli të vlerësojë rrethanat konkrete të çdo rasti. Për sa më sipër, Gjykata është bindur se Plenarja i ka marrë parasysht konstatimet e bëra në Aktvendimin e 26 prillit 2017.
93. Gjykata arrin në përfundimin se duke mbajtur parasysht detyrimin e Dhomave të Specializuara për të gjykuar dhe funksionuar në përputhje me Kushtetutën dhe të drejtën ndërkombëtare për të drejtat e njeriut sipas nenit 3(2) të Ligjit, rregulla 41 nuk është në mospërputhje me Kapitullin II të Kushtetutës.



## KAPITULLI 4 FLETËTHIRRJA, ARRESTIMI DHE PARABURGIMI

### 94. Pjesa III: Paraburgimi

#### **Rregulla 57(4) Rishikimi dhe rivlerësimi i mbajtjes në paraburgim**

Në Aktvendimin e 26 prillit 2017, Gjykata konstatoi se rregulla 54(4) nuk ishte në përputhje me nenin 29 të Kushtetutës në lidhje me të drejtën për liri dhe siguri. Gjykata konstatoi se kuptimi i drejtpërdrejtë i tekstit të asaj dispozite e kushtëzonte lirimin e një personi të paraburgosur tërësisht në varësi të pëlqimit të shtetit të tretë, edhe kur kërkohej lirimi i atij personi.<sup>32</sup> Për pasqyrimin e këtij konstatimi, Plenarja ka miratuar rregullën 57(4) e cila vijon më poshtë:

(4) ... Trupi gjykues dëgjon parashtrimet e një shteti të tretë në qoftë se personi i paraburgosur kërkon të lirohet në territorin e atij shteti. Personi i paraburgosur nuk lirohet në territorin e shtetit të tretë pa pëlqimin e atij shteti. Vendimi merret sa më shpejt që të jetë e mundshme dhe jo më vonë se tri (3) ditë pas parashtrimit të fundit.

95. Megjithëse është bindur se Plenarja i ka marrë parasysh konstatimet e saj, Gjykata vëren se dispozita e re mundëson mbajtjen e një personi deri në tri ditë pas një vendimi të panelit për lirimin e atij personi. Kjo mund të duket e tepruar.<sup>33</sup> Ndonëse një farë vonese në zbatimin e vendimit të lirimit të një personi shpesh është e pashmangshme, gjithsesi një vonesë e tillë duhet të jetë minimale.<sup>34</sup> Sidoqoftë, Gjykata pranon se në rrethanat e parapara në rregullën 57(4), vonesa në lirimin e një personi mund të mos jetë për shkak të Dhomave të Specializuara, por prej kërkesës së vetë personit për t'u liruar në një shtet të tretë.
96. Gjykata arrin në përfundimin se rregulla 57(4) nuk është në mospërputhje me Kapitullin II të Kushtetutës.

<sup>32</sup> Aktvendim i datës 26 prill 2017, para. 118-123.

<sup>33</sup> Për shembull, në çështjen *Labita v. Italy*, ankuesi paraqiti ankesë në lidhje me mbajtjen e tij në paraburgim për dymbëdhjetë orë pas shpalljes së pafajësisë. Pasi konstatoi se vijimi i mbajtjes në paraburgim nuk përbënte hapin e parë në përmbarimin e urdhrit për lirimin e tij, GJEDNJ-ja konstatoi shkelje të nenit 5(1) të Konventës. Shih *Labita v. Italy* [GC], nr. 26772/95, ECHR 2000-IV, para. 166, 172-174.

<sup>34</sup> *Giulia Manzoni v. Italy*, 1 korrik 1997, Raporte Aktgjykimesh dhe Vendimesh 1997-IV, para. 25.

## KAPITULLI 9 PROCEDURA E GJYKIMIT

### 97. Pjesa III: Provat

#### Nënpjesa 1: Pranueshmëria dhe vlerësimi i provave

##### **Rregulla 137                      Dispozita të përgjithshme**

Në Aktvendimin e 26 prillit 2017, Gjykata arriti në përfundimin se nuk mund të konstatonte se rregulla e mëparshme 134(3) përputhej me Kapitullin II të Kushtetutës, për arsyet e shtjelluara atje.<sup>35</sup> Gjykata vëren se Plenarja e ka fshirë atë dispozitë. Gjykata konstaton se rregulla 137 (më parë rregulla 134) nuk është në mospërputhje me Kapitullin II të Kushtetutës.

### 98. Pjesa IV: Vendimi i gjykimit

##### **Rregulla 161                      Statusi i personit të shpallur të pafajshëm**

Në Aktvendimin e 26 prillit 2017, Gjykata konstatoi se rregulla e mëparshme 158(2) nuk ishte në përputhje me nenin 29.1 dhe 29.2 të Kushtetutës në lidhje me të drejtën për liri dhe siguri. Konkretisht, Gjykata arriti në përfundimin se vijimi i mbajtjes në paraburgim të një personi të shpallur i pafajshëm në pritje të vendimit mbi apelin kundër pafajësisë së këtij personi, në mungesë të arsyeve për të dyshuar se ai person ka kryer vepër penale tjetër, nuk parashihej në ligj dhe nuk përbënte bazë të lejueshme që përlij privimin prej lirisë.<sup>36</sup>

99. Gjykata thekson se rregulla 161 (më parë rregulla 158) parashtron se kur një person i paraburgosur shpallet i pafajshëm, ai lirohet menjëherë, përveçse kur mbahet në paraburgim në mënyrë të ligjshme, ose vuan një dënim për vepra penale të ndryshme. Gjykata arrin në përfundimin se rregulla 161 nuk është në mospërputhje me Kapitullin II të Kushtetutës.

## PJESA III – PËRFUNDIM

100. Në përfundim, Gjykata konstaton se rregulla 19, rregulla 30 deri në rregullën 39, rregulla 41, rregulla 57, rregulla 137 dhe rregulla 161 nuk janë në mospërputhje me Kapitullin II të Kushtetutës.

101. Pasi ka kryer shqyrtimin e të gjitha dispozitave të Rregullores, Gjykata është bindur se Rregullorja e Procedurës dhe e Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës, në formën e miratuar nga Plenarja më 17 mars 2017 dhe rishikuar nga Plenarja më 29 maj 2017, përputhet me Kapitullin II të Kushtetutës.

<sup>35</sup> Aktvendim i datës 26 prill 2017, para. 190-193.

<sup>36</sup> Aktvendim i datës 26 prill 2017, para. 194-205.

**PËR ARSYET E LARTPËRMENDURA, GJYKATA NJËZËRI,**

1. *Deklaron* se Referimi është i pranueshëm;
2. *Vlerëson* se rregulla 19, rregulla 30, rregulla 31, rregulla 32, rregulla 33, rregulla 34, rregulla 35, rregulla 36, rregulla 37, rregulla 38, rregulla 39, rregulla 41, rregulla 57, rregulla 137 dhe rregulla 161, nuk janë në mospërputhje me Kapitullin II të Kushtetutës;
3. *Vlerëson* se Rregullorja e Procedurës dhe e Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës përputhet me Kapitullin II të Kushtetutës.

Përpiluar në anglisht dhe publikuar me shkrim më 28 qershor 2017, në Hagë, Holandë.

\_\_\_\_\_  
/nënshkrim/

**Gjykatëse An Pauër-Ford  
Kryesuese**

\_\_\_\_\_  
/nënshkrim/

**Gjykatës Roland Dekers**

\_\_\_\_\_  
/nënshkrim/

**Gjykatës Antonio Balsamo**